

KËRKESË

Kërkuese: Margarita Dhoska, e bija e Mistos dhe Dhoksisë, lindur më 1930 në Përmet, banuese në Patos.

Objekti: Shpall të vdekur shtetasin Nastas Dhoska në bazë të N.375 e vijues të K.Pr.C e N.15 e vijues të K.C.

Gjykata pasi dëgjoi pretendimet e kërkueses administroi provat dhe shqyrtoi çështjen në tërësi.

Kërkuesja Margarita Dhoska kërkon të shpallë të vdekur vjehrrin e saj.

Në vitin 1926 ai është larguar në shtetin Turk për emigrim ekonomik.

Ka mbi 20 vjet që familjarët e Nastasit nuk kanë asnjë të dhënë mbi ekzistencën e tij. Pretendimet kërkuesja i provon me thëniet e dëshmitarëve Sokrat Pitushi e Sotir Mitro, bashkëfshatarë të shtetasit Nastas Dhoska. Gjithashtu kërkuesja i ka paraqitur gjykatës dhe çertifikatën në bazë të së cilës Nastasi figuron i datëlindjes 7.3.1900.

Në këto rrethana gjykata konkludoi të shpallë të vdekur shtetasin Nastas Dhoskë Dhoska në dt.31.12.1970.

KËRKUESJA
Margarita Dhoska